

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Top-Product” shpk**

Sot, më 24.07.2023, themeluesi Z.Xhavit Krasniqi, atësia Beqir, lindur në Damanek dhe banues në Kosovë, adresa Malisheve,Fshati Damanek, lindur me 13.03.1987, i identifikuar me leternjoftimin Nr.960648, leshuar me Dt.11.11.2022, e vlefshme deri me Dt.10.11.2032.

**Neni 1
Themelimi**

Emri i shoqërisë është “Top-Product” shpk

- 1) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Import, eksport,tregti e produkteve ushqimore, patatinave, çokolllatave dhe të ngjashme.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Lgj.15, Rr.Princ Vidi, Nd.28, Durres
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (një qind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (Një) kuotë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- a) Ortaku themelues Xhavit Krasniqi, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqind mijë) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6
Administratori

- 1) Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) Administrator. Administratori i vetëm i shoqërisë **Z.Xhavit Krasniqi**, për një periudhë 5-vjeçare.

Neni 7
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKËT
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Top-Product" shpk

Xhavit Krasniqi

